



Pranuar / Dorezuar Punijeno/Prodato Received/Delivery	26.11.2021	1	viti god year
Organ /Njesia Org./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicima Quantity
SKMB/TK	5698/2021		1/4



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.873/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Arben Mehmeti-anëtarë, dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.873/2021 të datës 20.10.2021 të parashtruar nga ankuesi me adresë Rr. "Xheladin Hana", Nr.37, Prishtinë, kundër Organit të Punësimit - Administratës Tatimore të Kosovës, në çështjen juridike "Masë disiplinore-vërejtje", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 26.11.2021, mori këtë:

### V E N D I M

- I. **Aprovohet si e bazuar** ankesa me numër A.nr.873/2021 e datës 20.10.2021 e parashtruar nga ankuesi
- II. **Shfuqizohet** masa disiplinore "Vërejtje" e datës 16.09.2021 e shqiptuar nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejt, ndaj ankuesit.
- III. **Obligohet** Drejtori i Përgjithshëm, dhe Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore në Administratën Tatimore të Kosovës, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh të bëjë zbatimin e këtij vendimi, duke larguar masën disiplinore nga dosja personale e ankuesit.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

### A r s y e t i m

Ankuesi, Inspektor Tatimore në Administratën Tatimore të Kosovës, me datë 20.10.2021 ka parashtruar ankesën me numër protokollit 5094/2021 të regjistruar me numër A.nr.873/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër masës

disiplinore "Vërejtje" të shqiptuar me datë 16.09.2021 nga  
Kontrolli, njëherit udhëheqës i drejtpërdrejtë i ankuesit.

Udhëheqësi i Ekipit të

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 26.10.2021 ka kërkuar përgjigje në ankesën e ankuesit nga Administrata Tatimore e Kosovës. Këshilli më datë 04.11.2021 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova:** Ankesën me numër protokoll 5094/2021 të regjistruar me numër A.nr.873/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Emailin e datës 14.09.2021 nga ankuesi për Emailin e datës 13.09.2021 nga për ankuesin; Emailin e datës 13.09.2021 nga për Emailin e datës 02.09.2021 nga për ankuesin; Emailin e datës 31.08.2021 nga ankuesi për Emailin e datës 31.08.2021 nga për dhe ankuesin; Masën disiplinore vërejtje e datës 16.09.2021 të shqiptuar ndaj ankuesit; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 26.10.2021; Përgjigjen në ankesë e datës 04.11.2021; Akt Emërimit e datës 13.01.2021 të ankuesit; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punës janar-qershor 2019 për ankuesin; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punës i datës 26.12.2019, 27.01.2021; Emailin e datës 12.05.2021 nga Emailin e datës 12.05.2021 nga Emailin e datës 11.05.2021 nga Emailin e datës 11.05.2021 nga Emailin e datës 07.05.2021, 21.04.2021, 14.04.2021, 16.03.2021 nga Emailin e datës 04.11.2021 nga Emailin e datës 16.09.2021 nga për Emailin e datës 04.11.2021 nga për Emailin e datës 07.06.2021 nga për Emailin e datës 26.05.2021, 25.05.2021, 17.05.2021, 27.04.2021, 08.02.2021, 02.12.2020, 02.11.2020, 30.09.2020, 31.08.2020, nga Emailin e datës 04.08.2020 nga Emailin e datës 04.08.2020 dhe 01.07.2020, 02.06.2020, 08.05.2020, 14.04.2020, 11.03.2020, 11.02.2020, 20.02.2020, 22.01.2020, 15.01.2020, 14.01.2020, 25.10.2020, 16.09.2019 nga Raporti i detajuar për kontroll në vijim 25.05.2021; Raportin statistikor për kontrollin sipas ekipit; Raporti i detajuar për kontroll në vijim 17.05.2021; Raporti mujor mbi vizitat mars 2021; Emailin e datës 22.09.2021 nga Emailin e datës 22.09.2021 nga për Emailin e datës 15.03.2021 nga ankuesi për Raporti i Ekzaminimit Mikrobiologjik i datës 13.02.2021; Raport mbi analizat specifike në emër të ankuesit e datës 05.02.2021; Procesverbalin e paralajmërimit me gojë i datës 14.06.2021; Shkresën për caktimin e rasteve për kontroll nga Administrata Tatimore e Kosovës i datës 22.11.2019; Plotësimin e ankesës nga ankuesi më datë 08.11.2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit shkresave të lëndës të parashtruara nga palët, ka vërtetuar se ankesa e ankuesit është e bazuar, sepse:

Bazuar në shkresat e lëndës është konstatuar se Udhëheqësi i Ekipit të Kontrollit - njëherit udhëheqës i drejtpërdrejtë i ankuesit, me datë 16.09.2021 përmes shkresës me numër protokoll 282/2021 ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore "Vërejtje" me arsyetimin se i njëjti ka kryer shkelje të rëndë disiplinore për shkak të mosrespektimit të afateve kohore me rastin e



*shqyrtimit dhe vendosjes lidhur me kontrollin tek biznesi NTP "Edona" me numër unik 810683145 me pronar*

Ankuesi i pakënaqur me masën disiplinore të shqiptuar nga udhëheqësi i tij i drejtpërdrejt, me datë 20.10.2021 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor se masa disiplinore është shqiptuar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Zyrtarët Publikë.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ligj ky i aplikueshëm në rastin konkret, dhe si rrjedhoja ka konstatuar se: *Mospërbushja e detyrave të punës; Mosrespektimi i afateve të caktuara në përmbushjen e detyrave, dhe Moszbatimi i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale*, konsiderohen shkelje të rënda disiplinore, sipas nenit 46 paragrafi 2 nën paragrafi 2.1 dhe paragrafi 3 nën paragrafi 3.1, 3.2 dhe 3.3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë. Ndërsa me dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, përkatësisht nenin 8 përcaktohet se: *Ndaj nëpunësve civil, zbatohen masat e përcaktuara në nenin 47 të Ligjit. 2. Masa disiplinore e përcaktuar në nenin 47 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 i Ligjit jepet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i nëpunësit civil, nëse nëpunësi ka bërë shkelje disiplinore të përcaktuara në nenin 46 paragrafi 4 nënparagrafi 4.1, 4.2, 4.3 dhe 4.4 të Ligjit . 3. Masat disiplinore të përcaktuara në nenin 47 paragrafin 1 nënparagrafi 1.2, 1.3 dhe 1.4 i Ligjit shqiptohen nga Komisioni Disiplinor, nëse nëpunësi civil ka bërë shkelje të dispozitave të përcaktuara në nenin 46 paragrafi 3 nënparagrafët 3.1 deri 3.11 të Ligjit.*

Andaj, duke marr parasysh se veprimi i ankuesit, gjegjësisht mosrespektimi i afateve kohore me rastin e *shqyrtimit dhe vendosjes lidhur me kontrollin tek biznesi NTP "Edona"* është cilësuar si shkelje e rendë, Kolegji vlerëson se shqiptimi i masës disiplinore nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë është në kundërshtim me dispozitat e nenit 8 paragrafi 3 të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, sepse për shkelje të rënda kompetent për shqiptimin e masave disiplinore është vetëm Komisioni Disiplinor, siç përcaktohet me nenin 8 paragrafi 3 të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë.

Bazuar si me lartë, Kolegji konstaton se udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankuesit me rastin e shqiptimit të masës disiplinore "Vërejtje" gabimisht ka zbatuar ligjin material duke tejkuluar autorizimet dhe kompetencat e përcaktuara me dispozitat e nenit 8 paragrafi 2 të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, kështu që Vendimi i datës 16.09.2021 për shqiptimin e masës disiplinore ndaj ankuesit është i paligjshëm në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.


Andaj, pas konstatimit të paligjshmërisë se masës disiplinore në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji nuk u lëshua në trajtimin e pretendimeve tjera ankimore mirëpo vendosi për aprovimin e ankesës si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**Lënda me numër A.nr.873/2021**

**Avdyl BEKTESHI**

  
Procesmbajtës

**Jeton KOCA**  
  
Kryetar i Kolegjit



**Vendimi i dërgohet**

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimor të Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Administratën Tatimore të Kosovës; dhe
- Arkivot të KPMSHCK-së.

  
4